



**KËSHILLI I MINISTRAVE  
KËSHILLI KOMBËTAR I TERRITORIT**

**V E N D I M**

Nr. 9, datë 14.10.2020

**PËR  
MIRATIMIN E RISHIKIMIT TË PLANIT TË PËRGJITHSHËM VENDOR  
BASHKIA MIRDITË, TË MIRATUAR ME VENDIMIN NR. 2, DATË 20.06.2018,  
TË KËSHILLIT KOMBËTAR TË TERRITORIT**

Në mbështetje të neneve 7, 20, 25 dhe 26 të Ligjit Nr. 107/2014 “Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit”, i ndryshuar, të neneve 11 dhe 12 të Vendimit Nr. 686, datë 22.11.2017 të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e Rregullores së Planifikimit të Territorit”, të ndryshuar, të Vendimit Nr. 519, datë 20.09.2017 të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e përbërjes së Këshillit Kombëtar të Territorit”, i ndryshuar, të Vendimit Nr. 2, datë 20.06.2018 të Këshillit Kombëtar të Territorit “Për miratimin e Planit të Përgjithshëm Vendor Bashkia Mirditë”, me propozim të Kryetarit të Bashkisë Mirditë, si dhe referuar Vendimit të Këshillit të Bashkisë Mirditë Nr. 92, datë 30.09.2020 “Për miratimin e Dokumentit të Rishikimit të Planit të Përgjithshëm Vendor (PPV) të Bashkisë Mirditë”, Këshilli Kombëtar i Territorit,

**VENDOSI:**

1. Në Planin e Përgjithshëm Vendor Bashkia Mirditë, të miratuar me Vendimin Nr. 2, datë 20.06.2018, të Këshillit Kombëtar të Territorit, të bëhen ndryshime në dokumentin e:
  - *Rregullores së Planit, Shtojca II “Kushtet e Zhvillimit në nivel Njësie (Pasaportat)”, sipas Dokumentit të Rishikimit të Planit të Përgjithshëm Vendor Bashkia Mirditë, bashkëlidhur këtij Vendimi.*
2. Ngarkohen Bashkia Mirditë dhe Agjencia Kombëtare e Planifikimit të Territorit për botimin e Vendimit dhe dokumentit shoqërues të tij, në Regjistrin Kombëtar të Planifikimit të Territorit, si dhe për përditësimin e informacionit GIS dhe platformës e-Harta, sipas ndryshimeve të miratuara.
3. Ngarkohen Bashkia Mirditë, Agjencia Kombëtare e Planifikimit të Territorit, si dhe autoritetet përgjegjëse për planifikimin dhe zhvillimin e territorit për zbatimin e këtij vendimi.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KRYETARI**

**EDI RAMA**

**MINISTËR I LINJËS**

**BELINDA BALLUKU**

**MINISTËR I INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË**



**ANËTAR / SEKRETAR I KKT**

**DREJTOR I AGJENCISË SË ZHVILLIMIT TË TERRITORIT**

**LEDIA TOTA**

